

Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit: “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Qëllimi i këtij projektligji është ngritja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si autoritet kombëtar dhe strukturë e posaçme qendrore, e cila është përgjegjëse për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale ose veprimtari kriminale, të cilat mund ti nënshtrohen ngrirjes së përkohshme, sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.

ZRA gëzon pavarësi operationale dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe përgjegjësi bazohet në parimet e profesionalizmit dhe integritetit, respektimi të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, urgjenca dhe efikasiteti, besimi reciprok, konfidencialiteti, pavarësia operationale, paanshmëria politike, komunikimi i drejtpërdrejtë dhe elektronik, ruajtja e informacionit të klasifikuar.

Objektivi i këtij projektligji është krijimi dhe funksionimi i ZRA në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, në përmbushje të objektivave dhe prioriteteve të Qeverisë së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme, specifikuar në Planin Kombëtar të Integritetit European 2024-2026 dhe Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2024.

Në vijim të sa më sipër, projekt-akti u publikua për konsultim publik në platformën RENJKP gjatë periudhës 26 qershor 2024 deri më 25 korrik 2024. Gjatë kësaj periudhe, projekti pati 279 lexime, por nuk u regjistrua asnjë koment nga përdoruesit e platformës.

Vlen të përmendet se projekt-akti ishte konsultuar më parë në të njëjtën platformë, nga data 5 mars 2024 deri më 25 mars 2024. Në atë periudhë, u shënua një interes më i madh, me 638 lexime, por asokohe gjithashtu nuk pati asnjë koment të regjistruar. Rihedhja e tij për konsultim publik u bë për shkak të rishikimeve dhe ndryshimeve të realizuara në disa elementë të përmbajtjes pas bashkërendimit me ministritë e linjës.

Pavarësisht dy fazave të konsultimit, projekti nuk mori komente, as përmes RENJKP dhe as përmes e-mailit të koordinatorit të konsultimit publik, duke treguar një interes të kufizuar të palëve, për këtë akt.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”, janë përdorur katër metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet prej datës 26 qershor 2024 deri në 25 korrik 2024, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projekt aktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 56, datë 28.4.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projektaktit dhe diskutime të detajuara mbi politikat e propozuara.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projekt aktin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;
4. Takime dhe tryeza teknike me përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe Këshillit të Evropës dhe Ministrisë së Brendshme, “Veprimi kundër krimit ekonomik” si dhe me ekspertizën e Specialistëve të ZRA Franceze.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme në MB;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtoria e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Ekspertët e organizatave ndërkombëtare;

- Koordinator për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJKP.

5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi